



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Raporti i të drejtave të njeriut, 2006, Shqipëri

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizata e parë joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, është themeluar si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut dhe është regjistruar me vendimin nr. 17/1 të Ministrisë së Drejtësisë, datë 12.1.1991. Më 22 mars 1992 organizata u anëtarësua pranë Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me emërtimin Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Misioni kryesor i KShH-së është: vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, rivendosja e të drejtave të shkelura, ndërgjegjësimi i shtetasve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre dhe përmirësimi i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve. Pjesë e këtij misioni është, gjithashtu, edhe rritja e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të kësaj administrate.

Raporti trajton gjendjen e të drejtave të njeriut në disa nga fushat ku KShH-ja ka punuar gjatë vitit 2006 si dhe zhvillimet me të rëndësishme të ndodhura në vitin 2006, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, ndikojnë në gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Qeverisja e mirë dhe shteti i së drejtës

Më 3 korrik 2005 u zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Ato u fituan nga koalicioni i djathtë i kryesuar nga Partia Demokratike. Është pozitiv fakti që pushteti kaloi në mënyrë paqësore nga koalicioni i majtë në atë të djathtë. Megjithatë, edhe në këto zgjedhje nuk u arritën standardet e kërkuara.

Qeveria shqiptare paraqiti programin e vet të qeverisjes, në të cilin vazhdon të jetë përparësi lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Edhe në raportet e BE-së dhe të organizmave të tjerë monitorues, lufta kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, si dhe forcimi i sistemit gjyqësor janë përcaktuar si përparësi për Shqipërinë në procesin e integritimit europian. Gjatë vitit 2006, qeveria shqiptare ndërmori disa nisma për të minimizuar dukurinë e korrupsionit e cila është e ndjeshme në disa sektorë të ekonomisë dhe në disa institucione. Lufta kundër kriminalitetit, trafikimit, lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar ishte, gjithashtu, përparësi e qeverisë shqiptare. Në 12 qershor 2006, Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e asociim-stabilizimit me Bashkimin Europian. Kjo ishte një arritje e madhe për të gjithë shqiptarët dhe kurorëzim i përpjekjeve të saj në vite, por edhe fillimi i një sërë reformash në fushat më të rëndësishme të jetës.

Gjatë vitit 2006 u ndërmorën nisma për miratimin e disa ligjeve të rëndësishme që do të kontribuonin në thellimin e mëtejshëm të reformave. Megjithatë, praktikat e ndjekura për miratimin e tyre në disa raste nuk kanë qenë të suksesshme, sepse janë hartuar me nxitim dhe se konsultimet me grupet e interesit kanë qenë të kufizuara. Është kjo një nga arsyet që presidenti i Republikës ka kthyer për shqyrtim ligjet e miratuara ose nuk ka dekretuar ndonjë prej tyre¹. Jo pak nisma ligjore janë bërë objekt shqyrtimin në Gjykatën Kushtetuese.

Mënyrat e kryerjes së një pjese të reformave kanë hasur kundërshtime nga opozita ose forca brenda maxhorancës, nga media, analistë, specialistë dhe aktorë të shoqërisë civile. Një nga nismat e para të diskutueshme që ka shkaktuar debate lidhur me respektimin e shtetit të së drejtës, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ishte kufizimi i imunitetit të deputetëve. Në fund të vitit 2005, në Parlamentin shqiptar u paraqit një projektvendim për kufizimin e imunitetit të deputetit duke i mundësuar prokurorit të drejtën të fillonte ndjekjen penale kundër deputetit, pa marrë më parë autorizim nga Parlamenti për ndjekjen penale.

Disa organizata të të drejtave të njeriut, konstitucionalistë dhe ekspertë të pavarur, ndër të cilat edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, reagues publikisht ndaj këtij projekti duke argumentuar se ai binte ndesh me nenin 73 të Kushtetutës ku thuhet se: “Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht, pa autorizimin e Kuvendit”. Për këtë çështje, më 10 tetor 2005, KShH-ja dhe disa OJF të tjera u ftuan në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe Kushtetuese për të shprehur opinionet e tyre. Sipas tyre, për të kufizuar imunitetin duhej amenduar neni 73 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për shkak të kundërshtive të madha, projekti u tërhoq nga axhenda parlamentare dhe iu dërgua për ekspertizë Komisionit të Venecias. Në muajin mars 2006, Komisioni i Venecias sollti një raport lidhur me këtë çështje ku i rekomandonte qeverisë shqiptare nevojën e amendimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në rast se do të donin kufizimin e imunitetit të deputetëve.

Sic përmendet edhe më lart, një ndër shqetësimet e aktorëve të shoqërisë civile ka qenë moskonsultimi ose konsultimi i pamjaftueshëm i qeverisë me grupet e interesit dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile për disa projektligje të rëndësishme, zhvillimi i një procesi të hartimit të disa ligjeve, në mënyrë jo transparente për publikun, shoqërinë civile dhe rrethet e ekspertëve. Mungesa e diskutimit të tyre në radhë ekspertësh ka ndikuar negativisht në cilësinë e disa prej iniciativave. Edhe në rast se grupet e interesit kanë shfaqur mendimet e tyre, qeveria ose ligjvënësi jo gjithnjë i kanë marrë ato në konsideratë. Megjithatë, nuk mungojnë përvojat pozitive të bashkëpunimit në këtë drejtim mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe aktorëve të shoqërisë civile për strategjitë e policimit në komunitet, projektstrategjinë për parandalimin e kriminalitetit të të miturve dhe ndaj të miturve etj. Gjithashtu, grupet e interesit dhe përfaqësues të organizatave të të drejtave të njeriut janë thirrur dhe janë dëgjuar në komisionet parlamentare për disa nisma të rëndësishme ligjore.

¹ Në bazë të nenit 84 të Kushtetutës së RSH, nëse Presidenti nuk shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditësh nga paraqitja e tij, ligji quhet i shpallur.

Zgjedhjet

Pas zgjedhjeve të 3 korrikut 2005, në nëntor 2005, u bë i njohur raporti i OSBE/ODIHR-it për këto zgjedhje. Në këtë raport u paraqitën një seri rekomandimesh që duhej të mbaheshin parasysh në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor. Në janar të 2006-ës u ngrit një komision i posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore. Për shkak të mungesës së vullnetit politik, nga janari 2006 deri më 13 janar 2007, në Kodin zgjedhor nuk u bë asnjë ndryshim. Kjo gjë ndikoi negativisht në zhvillimin e debatit konstruktiv dhe të arritjeve të konsensusit midis partive politike, sidomos midis dy partive më të mëdha të pozitës dhe të opozitës.

Çështjet kryesore që u bënë burim mosmarrëveshjesh ishin: kërkesat për heqjen nga Kodi zgjedhor të dispozitave ligjore që bënin fjalë për regjistrin e përkohshëm të zgjedhësve dhe certifikatat e lindjes që do të shërbenin për votim; zgjedhja e një anëtari të KQZ-së nga spektri i djathtë, ndërsa opozita pretendonte se duhet të propozohej nga spektri i majtë; shtimi i numrit të anëtarëve të KQZ-së nga 7 në 9, gjë që kërkonte ndryshimin e nenit 154 të Kushtetutës si edhe shtimi i numrit të komisioneve zgjedhore më të ulëta dhe i grupeve të numërimit të votave nga 7 që ishin, në 14; koha (data) e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore. Fillimisht, data u caktua më 20 janar 2007, ndërsa, më vonë, pas marrëveshjes së 13 janarit 2007, presidenti i Republikës caktoi datën 18 shkurt 2007.

Në raportet paraprake të OSBE/ODIHR-it zgjedhjet e 18 shkurtit 2007 u konsideruan një shans i humbur. OSBE/ODIHR-i dhe KE-ja kanë rekomanduar kryerjen e një reforme zgjedhore me synim arritjen e standardeve që kërkohen. Për përmbushjen e detyrave të mësipërme janë bërë disa deklaratat, por ende nuk dimë të jenë përcaktuar afate konkrete se kur do të përmbushen këto detyrime.

Administrata publike

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Këshilli i Ministrave ka marrë masa të cilat kanë qenë të karakterit ligjor dhe strukturor. Reforma ka qenë më e ndjeshme sidomos për organet e tatim-taksave dhe për administratën doganore. Gjithashtu, ka pasur ndryshime strukturore të organizimit të administratës publike me qëllim reduktimin e mbivendosjeve të kompetencave, rritjen e efektivitetit të punës së tyre dhe zvogëlimin e shpenzimeve të administratës publike. Si pasojë e saj, një pjesë e administratës është shkrirë dhe një pjesë e saj është rinovuar me personel të ri. Në shumë raste ka pasur zëvendësim të personave me përvojë në fushën përkatëse, me persona të rinj të cilët kanë nevojë për trajnime dhe kualifikime të mëtejshme me qëllim rritjen e efektivitetit në punën e tyre.

Sipas informacioneve të marra nga Komisioni i Shërbimit Civil, reforma në administratën publike shpesh është shoqëruar edhe me largime të padrejta nga puna. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2005-2006 ka pasur shumë raste të largimit të personave nga detyra. Përveç largimit nga detyra, ka pasur edhe masa disiplinore për të cilat personave nuk u është krijuar mundësia për të dhënë sqarime dhe për t'u mbrojtur². Nga të dhënat

² Nga rastet e denoncuara, KShH-ja ka arritur në përfundimin se në rastet e largimit nga puna të tyre nuk është mbajtur parasysh parimi i sanksionuar në nenin 3 të ligjit "Për statusin e nëpunësit civil" ku thuhet se

që KShH-ja ka marrë pranë Komisionit të Shërbimit Civil në janar të 2006-ës, ka rezultuar se pjesa më e madhe e largimit nga detyra kanë qenë me motivacion politik dhe ka munguar transparenca dhe respektimi i ligjit.

Edhe në rastet kur Komisioni i Shërbimit Civil ka marrë vendime për rikthimin në punë të punonjësve të larguar nga puna pa shkak, institucionet të cilat janë të detyruara ta zbatojnë vendimin, nuk e kanë marrë parasysh atë. Në një informacion të dhënë nga kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil dhe të botuar në “Gazetën shqiptare” të datës 21 tetor 2006 rezulton se gjatë periudhës janar-shtator 2006 pranë këtij Komisioni janë depozituar 631 ankesa të punonjësve të administratës, të cilët kanë dalë tepër nëpër ministri e në institucione shtetërore për shkak të ristrukturimit. Nga vendimet që ka marrë Komisioni i Shërbimit Civil, rezulton se pjesa më e madhe e punonjësve janë larguar pa një arsye bindëse.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, sidomos kundër veprave penale në fushën e prodhimit dhe të shpërndarjes së narkotikëve, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9559, datë 8.6.2006, “Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1993, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”. Ligji bënte një përzjerje të funksioneve të kryetarit të njësive të qeverisjes vendore me ato të policisë. Kryetarëve të qeverisjes vendore u caktohen detyra që ata nuk i kanë, me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, miratim i të cilit ishte një cenim i nenit 81 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, ky ligj miratohet me 3/5 e të gjithë deputetëve, ndërsa ndryshimi që i është bërë ligjit për barnat narkotike dhe detyrimet e kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore, u miratua me shumicë të thjeshtë.

Para se ligji të kalonte për miratim në Kuvend, disa organizata të shoqërisë civile, mes tyre edhe KShH-ja, paraqitën komentet e tyre për këtë ligj. Sipas KShH-së, ligji bie ndesh me ligjin “Për organizimin e qeverisjes vendore” si dhe me frymën e Kushtetutës dhe të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale. KShH-ja dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, të medias, shprehën mendimin se qeveria shqiptare duhet të ndërtojë sisteme efektive për të parandaluar kultivimin e bimëve narkotike dhe jo të shkarkojë pamundësinë e strukturave përgjegjëse për zbulimin e krimit tek organet e qeverisjes vendore. Gjithashtu, në kuadër të luftës kundër trafikeve ilegale të njerëzve dhe të drogave, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr 9509, datë 3.4.2006, “Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë”, i cili ndalon për tre vjet lëvizjen e mjeteve motorike lundruese, si edhe transportin e mjeteve lundruese në rrugë tokësore. Sipas opinionit të KShH-së³, të organizatave të tjera të të drejtave të njeriut edhe të konstitucionalistëve, ligji kufizon të drejtat e shtetasve të parashikuara në

“Shërbimi civil është ndërtuar dhe vepron mbi bazën e profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe të korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi”. Gjithashtu, në nenin 25, pika 2, të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, kërkohet nga administrata publike që nëpunësit civil ndaj të cilit merret masa disiplinore, t’i garantojë të drejtën për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar.

³ Komentet e tij për projektligjin për ndalimin e lëvizjes së skafeve, KShH-ja ia ka dërguar z. Spartak Ngjela, kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë (kryetar në kohën kur është adresuar shqetësimi) më 15 shkurt 2006.

nenin 41 të Kushtetutës i cili garanton të drejtën e pronës private. Mjaft i diskutueshëm është edhe zbatimi i nenit 17 të Kushtetutës sipas të cilit këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”. Gjithashtu, me qëllim që të mos cenoheshin pronarët e këtyre mjeteve do të ishte e nevojshme që në ligj të parashikohej edhe dëmi që mund t’u shkaktohet pronarëve të ligjshëm të këtyre mjeteve për periudhën trevjeçare. Këto shqetësime u shprehën më 20 mars 2006 në një njoftim të përbashkët për shtyp të KShH-së, Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendrës së Studimeve Parlamentare, Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, të dalë pas tryezës së organizuar me mbështetjen e fondacionit SOROS.

Reforma ligjore në luftën kundër korrupsionit, disa vendime dhe projektligje të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë kanë shkaktuar debate të shumta. Për të intensifikuar luftën kundër korrupsionit u miratua ligji nr. 9508, datë 3.4.2006, “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”. Disa organizata të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe KShH-ja, paraqitën mendimet e tyre për disa të meta dhe pasaktësi që përmbante projektligji dhe që mund të cenonin të drejtat dhe interesat e ligjshëm të shtetasve. KShH-ja bëri oponentin e këtij projektligji dhe ia dërgoi atë Kuvendit të Shqipërisë para se ai të miratohej nga Kuvendi⁴. Në mars 2006, disa organizata të të drejtave të njeriut dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile diskutuan në një tryezë nevojën e luftës kundër korrupsionit, por duke respektuar të drejtat e njeriut dhe pavarësinë e institucioneve kushtetuese. Media e pavarur dhe analistë të saj kanë luajtur rol të rëndësishëm në informimin dhe sensibilizimin e publikut për nismat dhe problematikën e tyre.

Me gjithë thirrjet e përsëritura të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile drejtuar autoriteteve shtetërore dhe në mënyrë të veçantë Parlamentit dhe qeverisë shqiptare për të vlerësuar me kujdes respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në çdo nismë që ato ndërmarrin, disa ligje janë miratuar me votën e shumicës parlamentare.

Mungesa e konsultimeve me grupet e interesit ose mosmarrja parasysh e mendimeve të ekspertëve dhe të organizatave të të drejtave të njeriut, ka bërë që disa nisma të bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Në janar 2006, Këshilli i Ministrave miratoi tri vendime për sektorët e administratës publike, të doganave dhe të tatimeve. Avokati i Popullit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Studime Parlamentare dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar të deklarojë si antikushtetuese tri vendimet e mësipërme me argumentin se, duke qenë se ato kufizonin të drejtat e njeriut, kufizimet të mund të vendosen vetëm me ligj dhe jo me vendime të qeverisë (neni 17 Kushtetutës të RSH). Për më tepër, vendimet e Këshillit të Ministrave binin ndesh me nenin 18 të Kushtetutës ku thuhet se para ligjit të gjithë janë të barabartë, se nuk lejohet diskriminimi, si dhe me nenin 49 të Kushtetutës ku thuhet se secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me mjete të ligjshme që ka zgjedhur ose ka pranuar vetë, se ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese theksohej, gjithashtu, se këto vendime cenojnë edhe nenet 14, 17 dhe 18 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Me vendimin e saj nr. 20, datë 11.7.2006, Gjykata

⁴ Komentet e tij për projektligjin “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit” KShH-ja ia ka dërguar znj. Jozefina Topalli, kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, më 13 mars 2006.

Kushtetuese shpalli antikushtetuese tri vendimet e mësipërme të qeverisë dhe, veç sa më sipër, theksoi se vendimeve nuk mund t'u jepej fuqi prapavepruese.

Policia dhe kriminaliteti

Gjatë vitit 2006 ka pasur përmirësime në punën e Policisë së Shtetit. Përmirësimi ka qenë si në drejtim të angazhimit të policisë në luftën ndaj kriminalitetit, ashtu edhe në rritjen e forcës goditëse ndaj krimit, sidomos ndaj krimit të organizuar.

Në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së stabilizim asocimit, në planin kombëtar të veprimit për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit, të miratuar me vendimin nr.463, datë 5.7.2006, janë parashikuar shumë masa të karakterit ligjor dhe strukturor qëllimi i të cilave është forcimi i qëndrueshmërisë dhe i efektivitetit në punën e saj në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të Bashkimit Europian dhe detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e stabilizim asocimit⁵. Një ndër përparësitë afatshkurtra në këtë kuadër është ndryshimi i ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i cili vlerësohet se “do t'i japë frymëmarrje më të gjerë dhe shtysë të mëtejshme reformave të nisura për policinë⁶”

Projektligji “Për Policinë e Shtetit” hasi në kontestime të Avokatit të Popullit dhe të disa organizatave të të drejtave të njeriut. Në bashkëpunim me disa organizata të tjera të njeriut në vend KShH-ja bëri oponencën e këtij projektligji i cili, sipas tyre, kishte të meta dhe boshllëqe serioze. Në dhjetor 2005, Komisioni Parlamentar i Sigurisë Kombëtare organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe KShH-ja. Projektligji u kthye për rregullime dhe plotësime. Një pjesë e vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre u morën parasysht dhe u bënë korrigjimet dhe saktësimet e nevojshme.

Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2006 kriminaliteti ka pësuar rritje. Në këtë kuadër vlen të theksohet se kanë pësuar rritje veprat penale brenda familjes, krimet kundër pasurisë. Shqetësues për vitin 2006 ka qenë edhe rritja e dukurisë së vetëvrasjes: ka pasur 108 raste të vetëvrasjes dhe 59 raste të tentativës për vetëvrasje⁷. Edhe dhuna brenda familjes ka pësuar rritje gjatë vitit 2006. Më 23 janar 2006, një koalicion i organizatave jofitimprurëse, kryesisht të atyre që veprojnë në fushën e të drejtave të grave dhe të fëmijëve, i paraqiti Kuvendit të Shqipërisë projektligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Qëllimi i këtij projektligji është parandalimi dhe reduktimi i i dhunës në familje. Gjithashtu, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe e Shansëve të Barabarta, në bashkëpunim me shoqërinë civile, punuan për hartimin e strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje.

Me gjithë arritjet e punës së policisë në luftën kundër kriminalitetit, pranë KShH-së ka pasur raste të denoncimit për kryerjen e veprimeve arbitrare dhe përdorim të dhunës ndaj shtetasve nga ana e policisë. Gjithashtu, nga vëzhgimet që KShH-ja ka realizuar gjatë vitit 2006, ka rezultuar se policia ka ushtruar dhunë ndaj shtetasve gjatë arrestimit të

⁵ Për më shumë, shih vendimin nr.463, datë 5.7.2006, “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit”, titulli 3.24.11, “Policia”.

⁶ Shkëputur nga fjala që drejtori i përgjithshëm i Policisë ka mbajtur në analizën 6-mujore të Policisë së Shtetit për periudhën janar-qershor 2006.

⁷ Analiza 6-mujore e punës së Policisë së Shtetit për periudhën janar-qershor 2006.

tyre, gjatë transportimit për në komisariatit përkatës ose gjatë marrjes në pyetje në komisariatit e policisë.

Në datën 18 shkurt 2006 policia ka ushtruar dhunë ndaj G.XH., gazetar i televizionit “News 24” dhe të atit, në qytetin e Lushnjës. Dhuna është përdorur ndaj tyre në momentin e kontrollit, të shoqërimit për në komisariat dhe në mjediset e komisariatit të policisë, Lushnjë. Veprimet dhe dhuna e kryer ndaj gazetarit është konsideruar nga KShH-ja si arbitrare dhe e dënueshme. Për konfliktin e krijuar, çështja i kaloi për ndjekje penale organit të prokurorisë.

Më 17 qershor 2006, i mituri A. Përfundi, nxënës i vitit të tretë në shkollën e mesme të fshatit Pirg, Korçë, i dha fund jetës. Nga pretendimet e ngritura nga familjarë dhe shokë të tij rezultoi se viktima është keqtrajtuar nga organet e policisë ndërsa pyetej për një ngjarje të ndodhur në fshatin e tij. Familjarët e viktimës kanë treguar se ekzistenca e shenjave në trupin e tij dëshmon për ushtrimin e dhunës.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor

Respektimi i të drejtave të njeriut varet ndjeshëm nga pavarësia e sistemit gjyqësor dhe aksesit i publikut në to. Pjesë e reformës së përgjithshme ligjore ka qenë edhe ndryshimi i ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, organ i pavarur, i cili ka të drejtë të emërojë, të transferojë dhe të shkarkojë nga detyra ose të zbatojë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve. Me ligjin nr. 9448, datë 5.12.2005, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë bëri disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Procesi i hartimit të ligjit deri në miratimin e tij u shoqërua me debate në rrethet e juristëve dhe të ekspertëve. Presidenti i Republikës nuk e dekretoi ligjin, as nuk e ktheu atë në Parlament. Si rrjedhojë, ai hyri në fuqi automatikisht.

Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë e dërguan ligjin në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se ai vinte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 2, 3, 4, 5 e 6 të ligjit nr. 9448, datë 5.12.2005, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”⁸.

Konflikti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) me Kuvendin e Shqipërisë

Në muajin shtator 2006, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi dy anëtarë të KLD-së, ndërkohë që mandati i anëtarëve të KLD-së që do të zëvendësoheshin, nuk kishte mbaruar. Sipas ligjit, kur mbaron mandati i një anëtari të KLD-së, vendimi merret nga KLD-ja dhe kërkesa e këtij të fundit i drejtohet Kuvendit për zëvendësimin e tyre. Në këtë rast Kuvendi i Shqipërisë nuk respektoi kërkesat e ligjit.

⁸ Për më shumë, shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006, të Gjykatës Kushtetuese

Çështja e Prokurorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2006, një çështje tjetër e debatueshme që shkaktoi polemika dhe bojkot të seancave parlamentare nga ana e opozitës, ka qenë edhe kërkesa për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Pozita bëri akuza të shumta në drejtim të tij për shkelje të ligjit në përmbushje të detyrës. Në bazë të nenit 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me pëlqimin e Kuvendit dhe mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Kuvendit për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.

Për hetimin e çështjes kundër Prokurorit të Përgjithshëm, Kuvendi i Shqipërisë ngriti një komision hetimor. Opozita e kundërshtoi ngritjen e këtij komisioni me pretendimin se ai binte ndesh me Kushtetutën. Për këtë arsye, përfaqësuesit e opozitës nuk morën pjesë në përbërjen e këtij komisioni. Megjithatë, hetimi vazhdoi dhe, në përfundim të tij, Kuvendi i propozoi Presidentit të Republikës shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Presidenti i Republikës refuzoi këtë kërkesë me arsyetimin se nuk ishte i bazuar dhe se gjatë hetimit ishte shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë. Ai vendosi mosshkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Gjykata Kushtetuese që shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me vendimin nr. 26, datë 4.12.2006, e deklaroi veprimtarinë e komisionit hetimor të ngritur për këtë qëllim si antikushtetues.

Debate të tilla patën ndikim jo të mirë në punën e organit të prokurorisë dhe në besimin e publikut te ky organ.

Respektimi i të drejtave të shtetasve në sistemin e drejtësisë penale

Pavarësisht nga disa masa të marra, korrupsioni në organet e drejtësisë vazhdon të jetë shqetësim⁹. Në kuadër të reformës në organet e drejtësisë, në muajin dhjetor 2006, presidenti i Republikës së Shqipërisë mblodhi një tryezë për të diskutuar për reformat në pushtetin gjyqësor. Funksionimi i pushtetit gjyqësor, karriera e gjyqtarëve, forcimi i rolit të Konferencës Gjyqësore Kombëtare dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishin disa nga çështjet e shtruara për diskutim. Me gjithë përpjekjet e bëra, sistemi i drejtësisë vazhdon të përballet me dukurinë e korrupsionit dhe me mungesën e efektivitetit të duhur.

Zhvillimi i proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm kohor vazhdon të jetë problem. Vihen re shtyrje të seancave gjyqësore penale për shkaqe nga më të ndryshmet një pjesë e të cilave mund të parandaloheshin me një menaxhim më të mirë të punës së gjykatave, koordinimit të prokurorisë e gjykatave dhe profesionalizmit dhe respektimit të kodit të etikës së avokatëve. Zvarritja e proceseve gjyqësore për çështjet civile paraqitet edhe më shqetësuese.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore vazhdoi të ishte problem shqetësues. Zyrat e përmbarimit shfaqin probleme serioze duke mos dhënë siguri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile, ose administrative. Mekanizimi i kontrollit të ekzekutimit të

⁹ “Korrupsioni në Shqipëri; Perceptime dhe përvoja; Vrojtimi 2005”, i realizuar nga Institute for Development Research and Alternatives dhe Casals & Associates

tyre dhe nxjerrjes së përgjegjësisë është relativisht i dobët. Mungesa e fondeve, paqartësia e vendimeve gjyqësore dhe refuzimi i organizimeve shtetërore për të shlyer detyrimet gjyqësore sjellin pengesa në punën e zyrave të përmbartimit¹⁰. Megjithatë ka një përmirësim në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale, ky problem meriton ende vëmendje të veçantë. Ka pasur edhe raste të moszekutimit të vendimeve gjyqësore penale me arsyetimin e mbipopullimit në vendet e vuajtjes së dënimit.

Drejtësia penale e të miturve

Drejtësia e të miturve ka qenë një nga fushat e reformave të drejtësisë për vitin 2006. Disa organizata ndërkombëtare që punojnë në fushat e të miturve, si UNICEF-i, Terre des Home dhe aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile u angazhuan në vazhdimin e reformës së drejtësisë së të miturve. Pjesë e saj ishin propozimi i disa amendamenteve në Kodin penal dhe procedural penal, dënimet alternative, drejtësia restauruese etj. Disa projekte po zbatohen nga aktorë të shoqërisë civile.

Prej disa vitesh KShH-ja ka monitoruar reformën në sistemin e drejtësisë penale për të mitur si dhe ka dhënë ndihmesën e vet me anë të oponencës ligjore lidhur me amendamentet e paraqitura në vitin 2004¹¹ dhe të riparaqitura përsëri në vitin 2006. Me gjithë përpjekjet e bëra prej disa vitesh në këtë fushë, ndryshimet në legjislacion ende nuk kanë kaluar për miratim në Parlament.

Drejtësia e të miturve vazhdon të përballet me probleme të shumta. Nga monitorimi i kryer nga KShH-ja në disa prej gjykatave të rretheve gjyqësore¹² lidhur me vendimet gjyqësore të periudhës 2005 dhe një pjesë të vitit 2006 dhe nga vëzhgimet e proceseve gjyqësore me të mitur të zhvilluara gjatë periudhës shtator- tetor 2006 në gjykatën e Tiranës rezultoi se mungesa e infrastrukturës së nevojshme, mungesa e bazës nënligjore për zbatimin e alternativave të dënimit, mungesa e institucioneve edukuese për trajtimin e të miturve, mungesa e mjediseve të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e seancave publike në disa gjykata, sidomos në gjykatën më të madhe të vendit, në atë të Tiranës, mungesa e asistencës psikologjike ndaj të miturve krijonin vështirësi për zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe për vetë kërkesat e legjislacionit shqiptar për drejtësinë për të mitur.

Arresti në burg dhe arresti në shtëpi zbatohen gjerësisht ndaj të miturve. Shërbimi ligjor ndaj të miturve paraqet probleme. Ndonëse një pjesë e të miturve në kontakt me drejtësinë penale kanë pasur mbrojtje ligjore të ofruar nga avokatë të përzgjedhur nga familja, niveli i mbrojtjes lë për të dëshiruar. Shërbimet ligjore dhe sociale të ofruara nga organizata të shoqërisë civile ende nuk mbështeten nga fondet publike, por nga donacione të huaja dhe janë tërësisht të varura prej tyre. Shumë procese penale ndaj të miturve zgjatin tej afateve të arsyeshme. Ligji parashikon përjashtimin e të miturit nga dënimi ose uljen e dënimit nën minimumin e caktuar nga gjykata, por dispozita të tilla kanë gjetur zbatim të pakët. Për shkak të mungesës së strukturave mbikëqyrëse për zbatimin e masave alternative, ato nuk kanë qenë shumë të përdorshme.

¹⁰ Raporti progresiv për Shqipërinë, Komisioni Europian, Tiranë, më 8 nëntor 2006.

¹¹ pjesë të kësaj oponencë mund të gjenden në faqen e internetit www.ahc.org.al

¹² Studimi u shtri në 7 gjykata të rretheve gjyqësore Tiranë, Fier, Elbasan, Gjirokastër, Shkodër, Korçë dhe Vlorë dhe u krye gjatë periudhës maj –shtator 2007.

Drejtësia shqiptare për të mitur ende nuk ka në qendër të vëmendjes së saj “interesin më të lartë të fëmijës”. Në vitin 2007, Presidenti i Republikës dekretoi krijimin e seksioneve penale për të miturit.

Respektimi i të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar

Respektimi i të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar ka qenë një nga fushat e veprimtarisë së KShH-së gjatë vitit 2006. Reforma ligjore në fushën e paraburgimit dhe në burgje ka qenë e fokusuar më shumë në hartimin e akteve nënligjore sesa në ndryshime ose përmirësime të ligjeve. Ndonëse në vitin 2005 ishte përgatitur një paketë ligjore për drejtësinë e të miturve, pjesë e së cilës ishin edhe disa ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe “Ekzekutimin e vendimeve penale”, kjo paketë nuk kaloi për miratim në Parlament¹³.

Gjatë vitit 2006 u miratua rregullorja e re e paraburgimit¹⁴. Para miratimit, ajo iu nënshtrua një procesi vlerësimi dhe opionence nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve, mes tyre edhe KShH-ja. Miratimi i saj ka ndikuar pozitivisht në respektimin e të drejtave të personave në këto vende. Gjithashtu, disa përmirësime janë bërë në infrastrukturën e disa burgjeve, si: krijimi i mjediseve të reja të pritjes së familjarëve të të paraburgosurve në institucionin e paraburgimit nr. 313, në rrugën “Jordan Misja” në Tiranë dhe shtimi i numrit të punonjësve socialë dhe psikologëve me kohë të pjesshme në burgje.

Gjatë vitit 2006 KShH-ja monitoroi gjendjen e respektimit të të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e Komitetit kundër Torturës i Këshillit të Europës (CPT), Avokatit të Popullit dhe rekomandimet e bëra autoriteteve shtetërore nga vetë KShH-ja gjatë monitorimeve të mëparshme. Një pjesë e rekomandimeve të CPT-së të paraqitura në raportin e saj të vitit 2005 lidhur me paraburgimin nuk ishin zbatuar.

Gjendja në vendet e paraburgimit në komisariatet e policisë ishte e rëndë dhe nuk kishte përmirësime nga vitet e mëparshme. Ato nuk plotësonin asnjë nga parametrat e përcaktuar në ligj. Sistemi i paraburgimit vazhdonte të ishte në mjediset e komisariateve të policisë në varësi të Ministrisë së Brendshme. Vetëm në muajin janar 2007 filloi procesi i ndërprerë i transferimit të vendeve të paraburgimit i cili në përgjithësi ka ecur mirë.

Përdorimi i dhunës dhe veprimet degraduese sidomos për shkak të kushteve në vendet e paraburgimit mbetën ende shqetësim, ndonëse me përmasa më të pakta. Gjatë vitit 2006, KShH-ja mori ankesa nga personat e arrestuar dhe të dënuar për shkelje të të drejtave të tyre. Verifikimi i pretendimeve të tyre ishte i vështirë, pasi atyre nuk u mundësohej e drejta e informimit dhe e komunikimit në kohë me organizatat e të drejtave të njeriut, me përjashtim të takimeve me prokurorët e çështjeve. Gjithashtu, verifikimi i pretendimeve të tyre vështirësohej edhe për faktin që ata nuk kanë pasur mundësi të shiheshin nga një mjek ligjor menjëherë pas ushtrimit të dhunës ose përdorimit të forcës.

¹³ Për këtë çështje do të flitet në pjesën lidhur me respektimin e të drejtave të të miturve në kontakt me sistemin e drejtësisë penale.

¹⁴ Rregullorja e paraburgimit, e miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, nr. prot. 3705/1, datë 11.5.2006.

Në shumicën e institucioneve të vuajtjes së dënimit të vëzhguara u vunë re mungesa të pajisjeve dhe të mjeteve të nevojshme për pastërtinë vetjake. Pjesa më e madhe e materialeve për pastërtinë vetjake siguroheshin nga vetë familjarët e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Probleme paraqiste trajtimi i personave homoseksualë në komisariatet e policisë dhe në burgje. Sipas verifikimeve të kryera nga KShH-ja lidhur me arrestimin në flagrancë të personave N.A., F.H., B.L. dhe F.M., të akuzuar për veprat penale të marrëdhënieve seksuale në vendet publike dhe të ushtrimit të prostitucionit në bashkëpunim, të paraburgosurit në institucionin e paraburgimit nr. 302, Tiranë, pretenduan se nuk ishin informuar me të drejtën e tyre për të zgjedhur mbrojtës, për arsyet e ndalimit, akuzën dhe provat përkatëse në mbrojtje të saj. Kjo ka sjellë si pasojë humbjen e afateve të ankimit ndaj vendimit të vlerësimit të masës së arrestit. Lidhur me këtë çështje, KShH-ja ka informuar prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për verifikimin e pretendimeve për shkelje procedurale dhe marrjen e masave konkrete.

Me gjithë përpjekjet e bëra nga administrata e burgjeve, norma e ushqimit në burgje dhe paraburgime vazhdon të ishte e njëjtë në po atë nivel që ishte përcaktuar në vitin 1974. Në korrik të vitit 2006 u lëshua një urdhër i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Shëndetësisë i cili sanksiononte përmirësimin në sasi dhe në përmbajtje të menusë për të dënuarit që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare. Por, pavarësisht nga kjo, ky urdhër ende nuk ishte vënë në zbatim brenda vitit 2006.

Gjatë vitit 2006 u vunë re disa ndryshime të vogla pozitive në disa burgje, si: vënia në përdorim të plotë e laboratorit dhe e shërbimit ambulator në spitalin e burgut; përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në këtë institucion; marrja e masave konkrete për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në institucionin e paraburgimit nr. 302 në Tiranë për kartelizimin e të gjithë të paraburgosurve, diagnostikimin e tyre për sëmundjen e hepatitit C dhe vendosja e lidhjeve me Institutin e Higjienës¹⁵. Megjithatë, shërbimi shëndetësor në paraburgimet në varësi të Ministrisë së Brendshme ishte në gjendje shumë të rëndë. Në të gjitha paraburgimet e komisariateve të policisë dhe në paraburgimin e Vlorës mungonte plotësisht shërbimi stomatologjik. Në disa paraburgime të tjera mungonte mjeku ose baza materiale, barnat stomatologjike e mjekësore.

Trajtimi i të sëmurëve mendorë vazhdon të mbetet problem shqetësues dhe ende i pazgjidhur. Në shtator të vitit 2005, Ministria e Drejtësisë siguroi mjediset për ndërtimin e një institucioni të veçantë për të dënuarit e sëmurë në Durrës, por deri në fillim të vitit 2007 nuk u arrit të fillojë nga puna ristrukturimi i kësaj godine. Të sëmurët mendorë dhe fizikë vazhdojnë të mbahen në burgje së bashku me të dënuar të tjerë. Si pasojë e mostrajtit të specializuar i dënuari D.S. në burgun e Peqinit kishte tentuar disa herë të vetëvritej duke paraqitur në këtë mënyrë rrezikshmëri të lartë jo vetëm për shëndetin e tij, por edhe të administratës së burgut ku ai vuante dënimin. Lidhur me këtë rast, në korrik të vitit 2006, KShH-ja ka vënë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve duke rekomanduar vlerësimin e situatës konkrete me qëllim mbajtjen e këtij të dënuari nën mbikëqyrje dhe trajtim të vazhdueshëm nga ana e një mjeku psikiatër.

Punësimi i të dënuarve vazhdon të mbetet problem i pazgjidhur. Ndonëse është hartuar projektvendimi për punësimin dhe shpërblimin e punës së të dënuarve, ai nuk

¹⁵ Këto shqetësime janë ngritur në deklaratën e bërë publike nga KShH-ja në datën 13 korrik 2006 “Shërbimi shëndetësor në burgje vazhdon të mbetet problem i pazgjidhur”.

është miratuar ende nga Këshilli i Ministrave. Për të lehtësuar këtë proces, KShH-ja ofroi oponentë konstruktive dhe organizoi dy tryeza të rumbullakëta me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ekspertëve të huaj e me përvojë në këtë fushë dhe përfaqësues të burgjeve të veçanta që kanë kushte të përshtatshme për fillimin e punësimit të të dënuarve.

Mundësitë për veprimtaritë riedukuese në vendet e paraburgimit dhe burgje janë të pakta. Bibliotekat janë të varfra. KShH-ja mori nismën për pasurimin e bibliotekave me literaturë juridike dhe artistike. Nismës së saj iu bashkuan edhe disa organizata të drejtave të njeriut dhe donatorë të huaj të cilët ofruan botime për bibliotekat e burgjeve. KShH-ja kontribuoi me libra të ndryshëm, raporte, broshura, fletëpalosje informuese për të drejtat e njeriut. Gjatë vitit 2006 publikoi dhe shpërndau 1000 kopje të pankartës së titulluar “Të drejtat dhe detyrimet e personave të dënuar” dhe mundësoi botimin e një buletini mujor “Rikthim në shoqëri” i cili u shpërndahet të dënuarve dhe administratës së burgjeve. Me miratimin e “Rregullave të sjelljes” për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nga ministri i Drejtësisë në vitin 2005, KShH-ja jo vetëm asistoi grupin e punës për hartimin e këtyre rregullave, por, në vitin 2006, mundësoi edhe botimin e 3500 kopjeve të “Rregullave të sjelljes”.

Gjatë vitit 2006 u vu re një rritje e numrit të ankesave të të dënuarve për administratën lokale të këtyre institucioneve, sidomos për mënyrën e trajtimit nga personeli me uniformë në burgje. Pothuajse në pjesën më të madhe të rasteve, KShH-ja ka dërguar grupe verifikimi, por verifikimi i pretendimeve të tyre ka qenë i vështirë. Komunikimi me administratën e burgjeve lidhur me ankesat e adresuara ka qenë pozitiv, por në pak raste është pranuar ekzistenca e problemit.

Vënia në lëvizje e organit të prokurorisë në raste të pretendimeve për shkelje të të drejtave të personave të dënuar ka rezultuar më pozitive. Në rastin e dhunës së ushtruar më 16 nëntor 2006 ndaj të dënuarve A.M dhe A.Sh. që vuajnë dënimin në burgun e Krujës, pas ndërhyrjeve të KShH-së për verifikimin e ankesave dhe njoftimit të organit të prokurorisë së vendit ku ndodhet institucioni, prokuroria e rrethit gjyqësor Krujë nisi hetimet dhe nga verifikimet paraprake të saj rezultoi se në këtë ngjarje kanë qenë të përfshirë dy punonjës me uniformë të administratës së këtij burgu. Sipas informacionit të dërguar nga kjo prokurori në adresë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, ndaj punonjësve që kanë ushtruar dhunë, është marrë masa e pushimit nga detyra dhe ka nisur procedimi penal. Gjithashtu, KShH-ja ka sinjalizuar për raste të tilla prokuroritë e rretheve gjyqësore Tepelenë, Elbasan dhe Kavajë sipas të cilave nuk është arritur të vërtetohen pretendimet për ushtrim dhune.

Ka pasur raste kur të dënuarit kanë pretenduar se u kontrollon dhe u censurohet korrespondenca e tyre me institucionet shtetërore, sidomos ajo me organizatat e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga angazhimi i KShH-së, këto raste kanë qenë shumë të vështira për t’u verifikuar. Gjatë vizitave monitoruese, të dënuarit pretendonin se në pjesën më të madhe të rasteve, dhënia e lejeve shpërblyese dhe e lejeve të veçanta nga ana e administratës së burgjeve refuzohej ose ato jepeshin mjaft të reduktuara¹⁶. Dhënia e lejeve të tilla, sipas tyre, u refuzohej për shkak të frikës së moskthimit në burg të të dënuarit edhe kur ata plotësonin të gjitha kushtet e përcaktuara në ligj. Ky fakt u pranua edhe nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

¹⁶ Në kuadër të objektivit të mbështetjes së institucioneve shtetërore, KShH-ja ka ofruar oponentë ligjore lidhur me përmirësimin e regjimit të lejeve të të dënuarve.

Gjatë vitit 2006, Komisioni Mbikëqyrës i Ekzekutimit të Vendimeve Penale me Burgim nuk funksionoi. Në muajin mars dhe korrik 2006, KShH-ja i kërkoi ministrit të Drejtësisë marrjen e masave konkrete për vënien në funksionim të plotë të Komisionit dhe ofroi rekomandime konkrete për mirëfunksionimin e tij duke e parë këtë çështje nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe standardeve ndërkombëtare. Shumë letra dhe shqetësime të organizatës sonë nuk kanë mundur të verifikohen dhe të zgjidhen nga ky Komision.

Zbatimi i masave alternative mbetet ende në nivele të ulëta. Një kuadër të një projekti të UNICEF-it, SIDA-s dhe Terre des Home, po bëhen përpjekje për fillimin e zbatimit të alternativave të tilla. Në mars 2006, KShH-ja, përmes ekspertizës së huaj, ka ofruar komente dhe sugjerime konkrete për lehtësimin e zbatimit të masave alternative dhe ngritjen e strukturave përkatëse.

Liria e medias

Media ka luajtur rol të rëndësishëm në informimin e publikut dhe denoncimin e korrupsionit dhe të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga përfaqësues të administratës publike. Megjithatë, gjatë vitit 2006, nga monitorimi që i është bërë medias, është vënë re anshmëria e disa mediave në pasqyrimin e dukurive politike dhe shoqërore. Gjithashtu, ka pasur media që kanë shkelur në mënyrë të përsëritur parimin e prezumimit të pafajësisë duke publikuar fytyra dhe emra personash të dyshuar për kryerjen e veprave penale, pa u dhënë ende vendimi gjyqësor i formës së prerë¹⁷. Në disa raste, në publikimin e lajmit nuk është treguar kujdes i mjaftueshëm për respektimin e etikës gazetareske.

Liria e medias dhe raportet me qeverinë kanë qenë një tjetër temë e diskutueshme. Gjatë vitit 2006, qeveria përgatiti një projektligj që kërkonte të ndryshonte numrin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit dhe të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit. Projektligji i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë parashikonte zgjedhjen e anëtarëve të KKRT-së dhe të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit nga Kuvendi me propozim të shoqërisë civile nga shoqatat e gazetarëve, juristë, politika etj¹⁸. Përfaqësues të medias dhe të shoqërisë civile kundërshtuan formulën e re të zgjedhjes së anëtarëve të KKRT-së duke argumentuar se ky ndryshim e vinte median nën kontrollin e qeverisë. Më 30 gusht 2006, dy partitë e mëdha (PD dhe PS) bënë një marrëveshje sipas së cilës KKRT-së do t'i shtoheshin edhe 3 anëtarë të tjerë, 2 prej të cilëve do të propozoheshin nga shoqëria civile dhe do të miratoheshin nga opozita, ndërsa 1 anëtar do të zgjidhej me konsensus të përbashkët. Deri më sot kjo marrëveshje nuk ka gjetur ende zbatim.

Një tjetër çështje e cila ka pasur jehonë në qarqet e medias ka qenë edhe vendimi i datës 31 gusht 2006 i Këshillit të Ministrave “Për transferimin e Teatrit Kombëtar dhe të Galerisë Kombëtare të Arteve në mjediset e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbërori”. Në zbatim të këtij vendimi, televizioni “Top Channel” ishte i detyruar të

¹⁷ Për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nga ana e medias, KShH-ja, së bashku me Qendrën e Studimeve Parlamentare dhe Forumin e Mendimit të Lirë, më 15 mars 2006 organizuan tryezë të rrumbullakët.

¹⁸ Për më shumë, shih ligjin nr. 9531, datë 11.5.2006, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

lëshonte mjediset pranë QNK-së në të cilën zhvillonte aktivitetin e tij, megjithëse kishte një kontratë të mëparshme për përdorimin e këtyre mjedisëve. Ky vendim, si nga media vendëse, ashtu edhe nga strukturat ndërkombëtare, u interpretua si goditje që qeveria i bënte medias së lirë në përgjithësi dhe “Top Channel” në veçanti. KShH-ja reagoi me një deklaratë publike duke i kërkuar qeverisë të rishikonte vendimin e saj.

Respektimi i të drejtave të minoriteteve

Trajtimi i minoriteteve ka njohur progres. KShH-ja vëren se gjatë periudhës 2006 ka pasur përmirësim në mbajtjen e evidencave të veçanta të minoriteteve nga ana e disa organeve të qeverisjes vendore, sidomos të minoritetit rom në vendet ku ai ka përqendrim më të madh. Megjithatë, një nga problemet që nuk ka gjetur ende zgjidhje, është mungesa e statistikave zyrtare të përditësuara për numrin e minoriteteve në Shqipëri.

Gjatë vitit 2006 ka pasur iniciativë për hartimin e një ligji për fetë në Shqipëri. Në këtë kuadër u realizua një takim me përfaqësues të institucioneve shtetërore, specialistë të fushës të angazhuar në dhënien e ekspertizës për hartimin e projekt marrëveshjes midis shtetit shqiptar dhe bashkësive fetare në Shqipëri, përfaqësues akademikë dhe të organizatave jofitimprurëse lidhur me nevojën e hartimit të një ligji për fetë në Shqipëri. Në kuadër të parandalimit të diskriminimit, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me disa organizata të tjera, ka hartuar një projektligj kundër diskriminimit i cili nuk është diskutuar ende në Parlament.

Megjithëse ekziston një ligj për shtypin, ai nuk i përshtatet zhvillimit që ka pësuar shoqëria dhe media. Për këtë arsye është e nevojshme të hartohet një ligj i ri që t’u përshtatet nevojave aktuale të medias dhe grupeve shoqërore në përgjithësi dhe atyre minoritare në veçanti. Në procesin e hartimit të këtij ligji është e mira të jenë edhe përfaqësues të minoriteteve. Për rritjen e aksesit të minoriteteve në programet e RTSH-së është e nevojshme rritja e rolit të përfaqësuesve të minoriteteve në Këshillin Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar.

Një pjesë e minoriteteve, sidomos në fshatrat ku ka një përqendrim të minoritetit grek dhe të minoritetit maqedonas, nuk kanë sinjal të mjaftueshëm të Radiotelevizionit Publik Shqiptar. Ky është një mjet i domosdoshëm që ndikon në mosveçimin, por edhe në integrimin e tyre me jetën e shoqërisë në përgjithësi.

Në vitin 2003 u miratua strategjia kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”. Zbatimi i saj ka qenë objekt monitorimi nga organizma të shoqërisë civile. Bazuar në të dhënat e monitorimit të disa organizatave, si: fondacioni i shoqërisë së hapur (SOROS), KShH-ja dhe CRCA-ja, rezultoi se zbatimi në praktikë i kësaj strategjie kombëtare ka hasur vështirësi të shumta dhe ka ecur me hapa të ngadaltë.

Gjatë vitit 2006, arritjet në këtë drejtim kanë qenë të pakta dhe modeste. Për realizimin e objektivave të përcaktuara, sidomos në nivel vendor, u vu re një mungesë e eficiencës së institucioneve shtetërore përgjegjëse në marrjen e masave përkatëse. U vu re, gjithashtu, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore dhe vendore për shkëmbimin e informacioneve lidhur me masat e realizuara dhe ato të porealizuara si edhe ndërmjet institucioneve shtetërore me organizatat romë dhe me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të minoritetit rom.

Ka pasur mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi të saj me strategjitë e tjera vendore ose kombëtare që tashmë janë të miratuara nga qeveria shqiptare. Për këtë qëllim

nevojitet një bashkërendim më i mirë i forcave dhe i përpjekjeve të përbashkëta për të arritur rezultate sa më pozitive.

Roli i organizatave romë nuk ka qenë në nivelin e duhur. Zhvillimi i dialogut me minoritetin rom nga ana e institucioneve shtetërore nuk ka qenë në nivelet e kërkuara. Në këtë drejtim ka ndikuar edhe mungesa e kapaciteteve të duhura profesionale të disa organizatave romë si edhe e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për monitorimin e strategjisë. Gjithashtu, objektivat e vendosur, afatet dhe buxhetet financiare të realizimit të objektivave të strategjisë nuk janë parashikuar në terma realistë, të qartë dhe të matshëm.

Respektimi i të drejtave të emigrantëve dhe të personave të kthyer

Në kuadër të marrëveshjeve që Shqipëria ka nënshkruar me vende të ndryshme të BE-së për kthimin e emigrantëve të parregullt, gjatë vitit 2006 në pikat kufitare me Greqinë ka vazhduar kthimi i emigrantëve shqiptarë pa dokumente të rregullta. Në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës janë kthyer çdo ditë mesatarisht 130-140 persona¹⁹, ndërsa në atë të Kakavijës janë kthyer mesatarisht 250 klandestinë çdo javë. Të gjithë të kthyerit ishin pa dokumente të rregullta dhe të kapur në afërsi të kufirit shqiptaro-grek.

Me gjithë përpjekjet që po bëhen për të parandaluar kalimet e paligjshme të kufirit, kjo dukuri vazhdon të jetë shqetësuese. Nga kontaktet që KShH-ja ka pasur me emigrantë të kthyer nga Greqia në pikën kufitare të Kapshticës, në shumë raste ka rezultuar që personat e kthyer janë përpjekur të kalonin përsëri kufirin në mënyrë ilegale.

Përgjithësisht, kontakti i emigrantëve shqiptarë me policinë në pikat e kalimit kufitar ka qenë i kënaqshëm, por ka vend për përmirësimin e etikës së komunikimit. Gjatë vitit 2006, rastet e keqtrajtimit të emigrantëve shqiptarë kanë qenë të rralla.

Infrastruktura e mjediseve pritëse dhe e mjediseve të tjera të disa prej pikave kufitare kishin mangësi. Në disa pika kufitare nuk kishte kushte të përshtatshme për punë të punonjësve, nuk kishte banja publike, hapësira për mbajtjen e personave të kthyer, pajisje me tabelat orientuese, udhëzimet për procedurat që duhet të zbatohen nga shtetasit që kalojnë në këto pika kufitare dhe as pajisje me sinjalet rrugore për orientimin e makinave. Në disa pika kufitare mungonte infrastruktura e nevojshme për intervistimin dhe trajtimin e personave të kthyer, nuk kishte inspektore të policisë femra për të marrë në pyetje gratë e kthyerat, të cilat mund të kenë qenë emigrante të parregullta ose edhe viktima të trafikut të qenieve njerëzore.

Mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare ka bërë që, në disa raste, punonjësit e policisë kufitare kanë ndihmuar personat e kthyer duke i asistuar me ushqim dhe transport nga të ardhurat e tyre personale.

Përpjekje modeste për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimit janë bërë në pikën e kalimit kufitar Kapshticë dhe në portin e Vlorës, por ka pasur edhe probleme të tilla që kanë çuar në një trajtim jo etik dhe të shpejtë të shtetasve, të pasagjerëve dhe të përpunimit të mjeteve të tyre.

¹⁹ Të dhënat e paraqitura në këtë pjesë të raportit janë marrë nga misionet e vëzhgimit të cilat janë shtrirë në disa pika kufitare, konkretisht: Muriqan, Kakavijë, Kapshticë, Qafë-Thanë, Morinë, Tri Urat si edhe në portin e Vlorës. Ato u kryen gjatë muajit prill 2006 dhe, më pas, gjatë muajve shtator dhe dhjetor 2006.

Në shumicën e pikave kufitare të monitoruara, në rastet e rritjes së fluksit, në festa dhe pushime, ka pasur probleme të lëvizjeve të tyre. Mungesa e mjediseve për qëndrimin e shtetasve shqiptarë jo në pak raste ka përbërë bazën për një trajtim jonjerëzor të tyre, duke i bërë ata të presin në radhë të gjatë, në diell ose në shi, me fëmijë dhe bagazhe.

Gjatë vitit 2006 u vunë re ndryshime të personelit drejtues të policisë kufitare në shumë pika kufitare. Ndryshimi i herëpashershëm i tyre ka sjellë vështirësi në përmirësimin e situatës dhe në inkurajimin e këtyre kuadrove dhe ka ndikuar negativisht në rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. KShH-ja asistoi Policinë e Kufirit dhe të Migracionit në përmirësimin e infrastrukturës informuese në pikat kufitare sidomos me botimin e fletëpalosjeve informuese në disa gjuhë, vendosjen e stendave me materiale informuese në shumicën e pikave kufitare. Gjatë vitit 2006 është punuar për hartimin e projektligjit të ri “Për të huajt” i cili nuk është miratuar ende.